


# Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2022

**Tiranë, më 29 Shtator 2022:** Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune gjatë vitit 2022, përfaqësojnë 99,0 % të ndërmarrjeve, nga 98,5 % që rezultuan në vitin 2021.

Të punësuarit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune përbëjnë 31,3 % të të punësuarve gjithsej të ndërmarrjeve, nga 27,8 % që rezultuan në vitin 2021. Përqindja më e lartë e të punësuarve që përdorin kompjuter vërehet në aktivitetin e informacionit dhe komunikimit me 78,9 %, e ndjekur nga aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 67,9 % dhe shërbimet administrative dhe mbështetëse me 60,9 %.


Fig. 1 Përqindja e të punësuarve që përdorin kompjuter në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik (%), 2022



Nga ndërmarrjet që përdorin kompjuter për qëllime pune në vitin 2022, 98,7 % e tyre kanë akses në internet nga 98,4 % në vitin 2021. Të punësuarit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune me akses në internet përbëjnë 29,2 % të të punësuarve gjithsej nga 26,2 % që rezultuan në vitin 2021.


Në vitin 2022, ndërmarrjet me 250+ të punësuar përdorin 100 % kompjuter me akses në internet. Në këtë grup ndërmarrjesh, 33,6 % e të punësuarve përdorin kompjuter me akses në internet.

**Fig. 2 Përdorimi i internetit në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2022**




Në vitin 2022, 99,0 % e ndërmarrjeve ka përdorur lidhje fikse në internet, e cila përfshin lidhjet e tipit ADSL, SDSL, VDSL, fibër optike (FTTP), teknologji kablore, etj nga 98,1 % që rezultuan në vitin 2021. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë patur shpejtësinë e shkarkimit të informacionit më të lartë se 30 Mbit/s është 63,0 % nga 54,5 që ishte në vitin 2021, ndërsa përqindja e ndërmarrjeve me mbi 100 Mbit/s është 22,1 %.

**Fig. 3 Shpejtësia maksimale për shkarkim dokumentash (%), 2022**




Faqja e internetit është përdorur nga nga 53,3 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet nga 45,0 % që rezultoi në vitin 2021.

**Fig. 4 Përqindja e ndërmarrjeve që kanë faqe interneti, sipas aktivitetit ekonomik (%), 2022**




Në vitin 2022, 13,8 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 31,6 %, pasuar nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 29,7 % dhe aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 25,6 %.

**Fig. 5 Shitjet on-line nëpërmjet faqeve të internetit/aplikacioneve sipas aktivitetit ekonomik (%), 2022**



Media sociale (Facebook, LinkedIn, Twitter, Youtube, Pinterest etj.) është përdorur nga 77,5 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, nga 69,0 % që rezultoi në vitin 2021.

**Fig. 6 Përdorimi i medias sociale në ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik (%), 2022**




Në vitin 2022, 38,6 % e ndërmarrjeve kryen takime në distancë duke përdorur Skype, Zoom, MS Teams, WebEx, etj dhe 42,0 % e ndërmarrjeve kishin akses në distancë në sistemin e postës elektronike (email), dokumentet e ndërmarrjes apo aplikacionet e biznesit ose në softuerët e ndërmarrjes.

Në vitin 2022, 66,2 % e ndërmarrjeve kanë përdorur masat, kontrollet dhe procedurat e aplikuara në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim sigurimin e integritetit, autenticitetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit së të dhënave dhe sistemeve.

Në vitin 2022, 5,5 % e ndërmarrjeve kanë përdorur robotë industrialë apo të shërbimit për të kryer detyra të caktuara automatikisht (saldim robotik, prerje lazer, mbikëqyrje, pastrim, transport, etj).

Në vitin 2022, 26,3 % e ndërmarrjeve kanë specialist të fushës TIK të cilët kanë si detyrë kryesore të zhvillojnë, operojnë apo të mirëmbajnë sisteme dhe aplikacione TIK të ndërmarrjes.

**Fig.7 Specialistët TIK sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2022**



Në vitin 2022, 46,7 % e ndërmarrjeve kanë zbatuar masat për uljen e sasisë së letrës së përdorur për printim dhe kopjim apo uljen e konsumit të energjisë të pajisjeve TIK, nga të cilat:

- 40,2 % e ndërmarrjeve ulën sasinë e letrës së përdorur për printim dhe kopjim
- 41,4 % e ndërmarrjeve ulën sasinë e konsumit të energjisë të pajisjeve TIK

# Metodologjia

INSTAT për matjen e nivelit të treguesve të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka kryer në vitin 2022 vërtetimin mbi “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar.

Termi “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” i referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit. Termi TIK është i ngjashëm me termin Teknologji Informacioni (TI), por fokusohet në teknologjitë e komunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi.

Qëllimi i vërtetimit “Anketa për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” është të mbledhë dhe shpërndajë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Për matjen e përdorimit të TIK, INSTAT ka intervistuar 1,907 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

## **Njësia e vërtetimit**

Njësia e vërtetimit është ndërmarrja me 10 e më shumë të punësuar, e rezultuar aktive nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve.

## **Fusha e mbulimit**

Në vërtetim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në nivel seksioni.

Seksionet	Përshkrimi
C	Industri përpunuese
D, E	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtim
G	Tregti me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave dhe motoçikletave
H	Transport dhe magazinim
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit
J	Informacioni dhe Komunikacioni
L	Pasuritë e patundshme
M (Grupet 69-74)	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinare)
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
S (Grupi 95.1)	Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit

### **Metoda e grumbullimit**

Grumbullimi i të dhënave është realizuar gjatë muajit Mars 2022 me anë të metodës CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me anketues me tabletë.

Periudha e referencës për variablat kryesore është koha e mbledhjes së të dhënave, tremujori i parë i vitit 2022. Për pyetjet në lidhje me Shitje/Blerje online, specialistët TIK, vlera e xhiros së kryer nga shitjet, etj periudha referuese është një vit më parë, viti 2021.

### **Përkufizime**

**Kompjuter:** Kompjuterat përfshijnë kompjuterat personalë, tabletët apo pajisje të tjera portabël si Smartphone apo Personal Digital Assistants (PDAs).

**Akses në Internet:** Termi “Akses në Internet” i referohet një lidhjeje të jashtme në Internet përmes një kompanie që operon si Ofrues i Shërbimit në Internet (Internet Service Provider – ISP).

**Website:** Faqja e internetit është një dokument me HyperText. Ekzistenca e një website i ofron ndërmarrjes potencial për një performancë më të mire, mundësi të reja për prezantimin e ndërmarrjes, produkteve, mundësi për njohje më të madhe dhe në të njëjtën kohë aksesin në tregje të reja dhe për rrjedhojë të ardhura më të larta. Faqet e internetit mund të ketë tekst, lidhjet HyperText, imazhe, video dhe zëra.

**Media Sociale:** Përdorimi i Mediave Sociale si psh: Facebook, Google+, Twitter, YouTube etj. i referohet përdorimit nga ndërmarrja të aplikacioneve që bazohen në teknologjinë e Internetit ose në platforma komunikimi për tu lidhur, krijuar dhe shkëmbyer përmbajtje online, me kliente, furnizues, ose partnerë, jashtë ose brenda ndërmarrjes.

**EDI, tip EDI i mesazheve:** Shkëmbimi elektronik i të dhënave (EDI) i referohet transmetimit të strukturuar të të dhënave ose dokumenteve ndërmjet organizatave ose ndërmarrjeve me anë të mjeteve elektronike. Ai gjithashtu i referohet posaçërisht një familje standardesh (të tipit EDI) dhe mesazheve të tipit EDI të përshtatshme për përpunim të automatizuar.

**Shitjet në Web:** Janë shitjet e bëra nëpërmjet një dyqani në internet (web shop), nëpërmjet formularëve në web në një faqe interneti ose ekstranet, ose aplikacione pavarësisht se si aksesohet në web (kompjuter, laptop, telefon celular etj.).

**Pagesa në internet:** Një pagesë në internet është një transaksion i integruar porosi-pagesë.

**Robotikë:** Sipas aplikimit të tyre, robotët mund të jenë robotë industrialë ose të shërbimit. Një robot industrial është një manipulues i kontrolluar automatikisht, i riprogramueshëm, me shumë qëllime, i programueshëm në tre

ose më shumë akse, i cili mund të jetë i fiksuar në vend ose i lëvizshëm për t'u përdorur në aplikacionet e automatizimit industrial. Një robot shërbimi është një makinë që ka një shkallë të autonomisë dhe është në gjendje të veprojë në një mjedis kompleks dhe dinamik që mund të kërkojë bashkëveprim me persona, objekte ose pajisje të tjera, duke përjashtuar përdorimin e tij në aplikacionet e automatizimit industrial.

**Specialistë TIK:** Konsiderohen ata punonjës të cilët si detyrë kryesore kanë të zhvillojnë, operojnë apo të mirëmbajnë sisteme dhe aplikacione TIK, të tillë si: specialistë të bazës së të dhënave, specialistë të mbështetjes ndaj TIK-ut, etj. Specialistët TIK kanë aftësitë përkatëse për të specifikuar, projektuar, instaluar, mbështetur, menaxhuar, vlerësuar ose kryer aktivitete kërkimore.

**Aksesi në distancë:** Mat gatishmërinë, kapacitetin ose vullnetin e ndërmarrjeve për të bërë të mundur që punonjësit e tyre të punojnë në distancë duke u lejuar atyre një qasje në distancë në burime të tilla si: aksesi në distancë në e-mail, aksesi në distancë në dokumente dhe sistemet TIK të ndërmarrjes.